AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
Nr. 2618 Prot.
Datë.më. 11.08.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK SHKODËR

Nr 479 Prot

Shkodër, më 02.08.2021

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Ofruesi publik i AFP-së, Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Shkodër, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

Instruktor (mësimdhënës) i formimit teoriko-praktik me kohë të pjesshme për kursin "Instalime dhe mirëmbajtje hidraulike" dhe "Instalime dhe mirëmbajtje e sistemeve ngrohëse ftohëse".
(1 mësimdhënës)

a) Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

1. **Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

a) letërmotivimin për pozicioni:
b) jetëshkrimin (CV-në);
c) kartën e identitetit;
d) diplomën;
e) librezën e punës;
f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore:
j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënës të mëparshëm;
l) të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës ...27.08.2021

DREJTOR

Meri MARKIÇI

Adresa: Rruga "Kongresi i Lushnjës", ndërtesa nr.7, hyrja nr.2, Tel 022400012, e-mail: drfppshkoder@yahoo.com